




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRI



URDHËR

Nr. 211, datë 10.11.2025

PËR

**NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS
PËR HARTIMIN E MIRATIMIN E PLANIT TË VEPRIMIT
PËR PËRMIRËSIMIN E RENDITJES SË SHQIPËRISË NË INDEKsin
E OECD-SË PËR POLITIKAT E NMV-VE, NË KUADËR
TË DOKUMENTIT TË POLITIKËS “AGJENDA KOMBËTARE
E REFORMAVE 2024-2027”**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 12 e 28, shkronja “d”, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr.90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për hartimin e miratimin e planit të veprimit për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në indeksin e OECD-së për politikën e NMV-ve, në kuadër të zbatimit të reformës 1.1.4 (hapi 5), të dokumentit të politikës “Agjenda Kombëtare e Reformave 2024 - 2027”.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga zëvendësministri përgjegjës për ekonominë pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe të ketë në përbërje përfaqësues të nivelit drejtues nga institucionet, si më poshtë vijon:

- a) 7 (shtatë) anëtarë përfaqësues nga strukturat, që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të ekonomisë, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit;
- b) 3 (tre) anëtarë përfaqësues nga strukturat, që i përkasin fushës së përgjegjësisë shtetërore të inovacionit, pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit;
- c) nga 1 (një) anëtar, përfaqësues prej secilës prej ministrive dhe institucioneve të mëposhtme:

- i. Ministria përgjegjëse për arsimin;
- ii. Ministria përgjegjëse për financën;
- iii. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën dhe energjinë;
- iv. Ministria përgjegjëse për turizmin;
- v. Ministria përgjegjëse për mjedisin;
- vi. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- vii. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive;
- viii. Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
- ix. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve;
- x. Qendra Kombëtare e Biznesit;
- xi. Agjencia Kombëtare e Falimentimit;
- xii. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;
- xiii. Agjencia e Prokurimit Publik;
- xiv. Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit;
- xv. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit;
- xvi. Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit;
- xvii. Agjencia Kombëtare e Mjedisit;
- xviii. Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve;
- xix. Agjencia e Inovacionit dhe Ekselencës;
- xx. Operatori i Blerjeve të Përqendruara;
- xxi. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike;
- xxii. Agjencia Shtetërore për Mbështetjen dhe Zhvillimin e *Startup*-eve dhe Lehtësuesve;
- xxiii. Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
- xxiv. Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë;
- xxv. Inspektorati Shtetëror i Mbrojtjes së Tregut;
- xxvi. Komisioni i Prokurimit Publik;
- xxvii. Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës.

3. Në mbledhjet e grupit ndërinstitucional të punës mund të ftohen të marrin pjesë edhe anëtarë përfaqësues nga Banka e Shqipërisë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë së Shqipërisë, nga institucione të tjera, ekspertë të jashtëm apo përfaqësues nga grupet e interesit, që lidhen me fushën e veprimtarisë së këtij grupi ndërinstitucional pune.
4. Grupi ndërinstitucional i punës, brenda muajit dhjetor 2025, duhet të realizojë detyrat e mëposhtme:
 - a) Të kryejë vlerësimin e pozicionit të Shqipërisë në indeksin e OECD-së për politikën e NMV-ve;
 - b) Të hartojë një raport, që identifikon e analizon dobësitë dhe pikat e forta të Shqipërisë dhe fushat për ndërhyrje të nevojshme mbi kuadrin ligjor, politikën, masat administrative dhe institucionale, si dhe impaktin financiar;
 - c) Të hartojë planin e veprimit për përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në indeksin e OECD-së për politikën e NMV-ve.
5. Drejtoria e Politikave të Nxitjes së Biznesit pranë ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit të ushtrojë rolin e sekretariatit teknik të grupit ndërinstitucional të punës dhe të ketë përgjegjësitë e mëposhtme:
 - a) Të kujdeset për organizimin e mbledhjeve të grupit ndërinstitucional të punës;
 - b) Të përpunojë materialet e grupit ndërinstitucional të punës, që do të përdoren për mbledhjet e tij;
 - c) Të organizojë takime në nivel teknik me të gjitha palët e interesuara;
 - ç) Të lehtësojë bashkëpunimin dhe koordinimin brenda grupit ndërinstitucional të punës;
 - d) Të kujdeset për koordinimin e punës me institucionet përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë, të lidhur me dimensionet e *SME Policy Index*, për përfshirjen e aktiviteteve në planin e punës, me qëllim zbatimin e rekomandimeve të raportit të *SME Policy Index* dhe përmirësimin e renditjes së Shqipërisë në këtë raport;
 - dh) Të mbajë komunikimet me zyrën e OECD-së, për të kuptuar më mirë raportin, rekomandimet e metodologjinë e vlerësimit.

6. Titullarët e institucioneve të përmendura në pikën 2 të këtij urdhri të dërgojnë, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e tij, emrat e përfaqësuesve të tyre në Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit.
7. Ngarkohet kryetari i grupit ndërinstitucional të punës, që, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të sigurojë fillimin e veprimtarisë së tij.
8. Ngarkohen institucionet, sipas pikës 2, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

